



RAPORTI I TRANSPARENCËS

2024

Për periudhën raportuese të mbyllur më 31.12.2024



 www.intrust.al

Rruga e Kosovarëve, Kompleksi Lake View, shkalla B, Kati 2,
Tirana, Albania

Hyrje	3
1. Struktura ligjore dhe e pronësisë	4
2. Përshkrimi i strukturës drejtuese	5
3. Sistemi i kontrollit të brendshëm të cilësisë	6
4. Informacioni mbi kontrollin e fundit të cilësisë	8
5. Lista e njësive ekonomike me interes publik, për të cilat është kryer auditimi ligjor gjatë vitit të fundit nga shoqëria e auditimit	8
6. Deklaratat e praktikave të pavarësisë	8
7. Kualifikimi i vijueshëm profesional	9
8. Informacioni financiar	9
9. Bazat e shpërblimit të ortakëve të angazhimit	9

Hyrje

Të nderuar partnerë, klientë dhe palë të interesuara,

Me kënaqësi ju paraqesim raportin tonë të parë të transparencës, i cili pasqyron angazhimin e INTRUST ndaj standardeve më të larta të profesionalizmit, integritetit dhe përgjegjshmërisë. Si një kompani e pavarur, e specializuar në shërbime auditimi dhe dhënies së sigurisë, konsulencë fiskale, kontabiliteti dhe këshillim biznesi, ky publikim shënon një hap të rëndësishëm në rrugëtimin tonë drejt forcimit të besimit dhe llogaridhënies.

Ky raport mbështetet në përvojën mbi 17-vjeçare të partnerëve të auditimit dhe ekipit tonë, të cilët, falë aftësive të avancuara profesionale dhe përdorimit të teknologjisë bashkëkohore, ofrojnë zgjidhje të përshtatura dhe të orientuara nga vlera për çdo klient.

Përmes këtij raporti, synojmë të ndajmë me ju jo vetëm transparencën e veprimtarisë sonë, por edhe përkushtimin tonë të vazhdueshëm ndaj cilësisë, etikës profesionale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të kapaciteteve tona njerëzore dhe teknologjike.

Ne besojmë se suksesi afatgjatë ndërtohet mbi besim, cilësi dhe partneritet. Prandaj, mbetemi të përkushtuar ndaj vlerave tona themelore – ekselencës profesionale, etikës së pakompromis dhe një qasjeje të personalizuar ndaj çdo angazhimi.

Ju falënderojmë për besimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme.

Me respekt,

Gerta Avrami & Edison Troshani

Partnerë të Auditimit

INTRUST shpk

1. Struktura ligjore dhe e pronësisë

INTRUST është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Shpk), e regjistruar në Shqipëri, me NIPT M22321014K me seli në Tiranë. Shoqëria është e themeluar në përputhje me legjislacionin e shoqërive tregtare në Shqipëri me objekt aktiviteti në: Kryerjen e Shërbimeve të auditimit dhe e shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë, të shërbimeve të lidhura, sipas përcaktimit të këtyre shërbimeve të dhëna nga IFAC (Federata Ndërkombëtare e kontabilistëve), kryerjen e shërbimeve të kontabilitetit. shërbimet e mbajtjes së kontabilitetit, deklarimeve tatimore dhe hartimit të pasqyrave financiare. Ngritjen, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike si dhe trajnimin profesional të personelit që është ngarkuar me funksionimin e këtyre sistemeve. Përgatitjen e raporteve periodike financiare sipas nevojave të drejtuesve të biznesit. Konsulencë ekonomike, financiare dhe fiskale. Përgatitjen e planeve të biznesit për nevojat e drejtuesve dhe për palët e treta, rivlerësim aktivitetesh, këshillime biznesi mbi mundësitë e zhvillimit, këshillime për fillim aktiviteti tregtar etj. Konsulencë fiskale, për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit fiskal. Shërbime të tjera të lidhura me shoqëritë tregtare, si: ndarje, bashkim, përthithje, administrim, likuidim, falimentim; rritje dhe zvogëlim kapitali; hetime të posaçme, përfaqësim në çështje gjyqësore që kërkojnë një ekspertizë kontabël ose fiskale, tregtare, ekonomike etj.

Në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator për auditimin në Shqipëri, shoqëria është regjistruar në regjistrin publik të shoqërive të auditimit pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë me Nr. 953 të regjistrit datë 02.08.2024.

Ortakët pjesëmarrës në kapitalin e shoqërisë janë:

Edison Troshani 80 %

Gerta Avrami 20 %

Administrator:

Edison Troshani

2. Përshkrimi i strukturës drejtuese

Ekipi ynë përbëhet nga 11 anëtarë profesionistë të kualifikuar dhe udhëhiqet nga dy partnerët drejtues:

Gerta AVRAMI

Partner Auditimi

17+ vite në shërbime të konsulencës të kontabilitetit & legjislacionit tatimor

Auditues Ligjor prej 2015

Edison TROSHANI

Partner Auditimi

17+ vite në shërbime të konsulencës të kontabilitetit & legjislacionit tatimor

Auditues Ligjor prej 2021

3. Sistemi i kontrollit të brendshëm të cilësisë

INTRUST operon sipas politikave dhe procedurave që promovojnë një kulturë të brendshme dhe bazohen në faktin se cilësia është thelbësore në kryerjen e angazhimeve. INTRUST ka adaptuar politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë dhe adresimit të rrezikut. Sistemet e kontrollit të cilësisë janë krijuar për të dhënë sigurinë e arsyeshme që firma dhe personeli i saj veprojnë në pajtim me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore e rregullatore dhe raportet e lëshuara nga firma dhe partnerët e angazhimit janë të përshtatshme për rrethanat.

Sistemi i kontrollit të cilësisë, përmban politika dhe procedura, mbi përgjegjësinë e drejtimit dhe qeverisjes për sistemin e kontrollit të cilësisë së firmës, pranimin e klientit, rivlerësimin për vazhdimin e klientit, planifikimin e angazhimit, kryerjen e angazhimit dhe dokumentimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin, etikën dhe pavarësinë, punësimin dhe rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, monitorimin dhe inspektimin.

Shoqëria ka kryer angazhimet e vitit 2023 në përputhje me kërkesat e Standardit ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë (ISQC) 1, "Kontrolli i cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të informacioneve financiare historike dhe angazhime të tjera të sigurisë e të shërbimeve të lidhura" dhe është në proces të implementimit të Standardit Ndërkombëtar për Menaxhimin e Cilësisë, (ISQM1).

Qeverisja dhe drejtimi (Tone at the top)

INTRUST ka krijuar një mjedis me objektivat e mëposhtme të cilësisë:

- Një përkushtim i dukshëm ndaj cilësisë nëpërmjet një kulture që ekziston në të gjithë shoqërinë;
- ❖ Kërkesa për të kryer vazhdimisht angazhime cilësore dhe për shërbimet e kryera sipas manualit të deklaratave të IAASB, duke njohur rolin e Intrust në shërbim të interesit publik;
- ❖ Rëndësia e etikës, vlerave dhe qëndrimeve profesionale;
- ❖ Përgjegjësia e të gjithë personelit për cilësinë në kryerjen e angazhimeve ose aktivitetëve brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe sjelljen e pritshme të tyre; dhe
- ❖ Rëndësia e cilësisë në vendimet dhe veprimet strategjike të shoqërisë, duke përfshirë prioritetet financiare dhe operacionale të saj;
- ❖ Partnerët drejtues janë përgjegjës dhe japin llogari për cilësinë;
- ❖ Drejtimi tregon një përkushtim ndaj cilësisë përmes veprimeve dhe sjelljeve të tij;
- ❖ Struktura organizative dhe caktimi i roleve, përgjegjësi dhe autoritetit është i përshtatshëm për të mundur hartimin dhe zbatimin dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të cilësisë;
- ❖ Nevojat për burime, duke përfshirë burimet financiare, teknologjike dhe intelektuale, planifikohen dhe burimet merren, shpërndahen, caktohen ose

përdoren në një mënyrë që është në përputhje me angazhimin dhe përkushtimin tonë për cilësinë. Burimet e tilla intelektuale duhet të jenë gjithashtu në përputhje me standardet e zbatueshme profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullore; dhe

- ❖ Burimet njerëzore, teknologjike ose intelektuale nga ofruesit e shërbimeve janë të përshtatshme për t'u përdorur në sistemin e brendshëm të kontrollit të cilësisë si në kryerjen e angazhimeve të auditimit ashtu edhe në shërbimet e tjera të ofruara.

Pranimi/vazhdimi i klientit

Me qëllimin e ofrimit të shërbimeve të sigurisë me cilësi të lartë pranohen ata klientë të cilët ndajnë vlerat dhe besimet thelbësore të INTRUST, të cilët plotësojnë kriteret kryesore të pranimit dhe janë të gatshëm të paguajnë një tarifë të drejtë për punë cilësore.

Disa prej kriterëve kryesore të pranimit/vazhimit të angazhimit:

- ❖ Klientë që veprojnë me integritet, në përputhje me ligjet dhe rregullat e aplikueshme, përfshirë kërkesat e parandalimit të financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave.
- ❖ Në pranimin e klientit zbatohen politikat e etikës dhe pavarësisë, dhe çdo klient i cili është i ndaluar nga këto politika refuzohet.

Gjatë procesit të pranimit të klientit, partneri që do të angazhohet, vlerëson gjithashtu nivelin e rrezikut të angazhimit dhe përcakton nëse përmbushen kërkesa për personel të specializuar, mbikëqyrje dhe rishikim. Sipas kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator edhe të standardeve të menaxhimit të cilësisë për çdo angazhim në auditimin e njësive ekonomike me interes publik caktohet rishikuesi i kontrollit të cilësisë së angazhimit.

Tërheqja nga një angazhim ose marrëdhënie me klientin

Procesi i mëposhtëm ndiqet kur shqyrtohet tërheqja nga një angazhim ose marrëdhënie me klientin:

- ❖ Partnerët do të ndërmarrin takime me drejtuesit e klientit dhe të ngarkuarit me qeverisje për të diskutuar veprimet që mund të ndërmerren, duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat përkatëse.
- ❖ Nëse për pasojë tërheqja konsiderohet e përshtatshme, shoqëria do të dokumentojë çështjet e rëndësishme që çuan në tërheqjen, duke përfshirë rezultatet e çdo konsultimi, përfundimet e arritura dhe bazën për këto përfundime. Shoqëria do të shqyrtojë gjithashtu nëse ka një detyrim profesional, rregullator apo ligjor për të raportuar tërheqjen e angazhimit tek çdo autoritet përkatës.
- ❖ Nëse ekziston një kërkesë profesionale, rregullore ose ligjore e cila e detyron kompaninë të vazhdojë angazhimin, arsyet për vazhdimësinë duhet të dokumentohen, duke përfshirë shqyrtimin e konsultimit me këshilltarin ligjor.

4. Informacioni mbi kontrollin e fundit të cilësisë

Autoriteti mbikëqyrës për cilësinë e auditimit është Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Gjatë vitit 2024 shoqëria nuk ka qenë subjekt i kontrollit për sigurimin e cilësisë.

5. Lista e njësive ekonomike me interes publik, për të cilat është kryer auditimi ligjor gjatë vitit të fundit nga shoqëria e auditimit

Në zbatim të pikës 23 të nenit 2 të Ligjit Nr. 10 091 datë 5.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", të ndryshuar dhe VKM nr. 17, datë 16.01.2019 "Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre", i ndryshuar, njësitë ekonomike me interes publik janë klasifikuar si në vijim:

- ❖ të gjitha njësitë ekonomike të listuar në bursë;
- ❖ bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jo banka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- ❖ shoqëritë e sigurimit dhe të ri sigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;
- ❖ shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2024 shoqëria ka audituar pasqyrat financiare të vitit të mbyllur në 31 dhjetor 2023, të shoqërive NjEIP si më poshtë:

Shoqëria	Industria ku operon
Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Sha	Energjetikë
Furnizuesi i Shërbimit Universal	Energjetikë
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike GROUP	Energjetikë
KESH Sha	Energjetikë

6. Deklaratat e praktikave të pavarësisë

Ne jemi të pavarur nga klientët tanë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i

BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

7. Kualifikimi i vijueshëm profesional

Partnerët dhe stafi duhet të plotësojnë kërkesat minimale të zhvillimit profesional të vazhdueshëm siç përcaktohen nga rregullat dhe rregulloret e organizatës profesionale të audituesve ligjorë në Shqipëri dhe çdo nevojë shtesë trajnimi të identifikuar të cilat janë të përshtatshme për nivelin dhe përgjegjësitë e tyre.

Partnerët e angazhimit, kryejnë kualifikimin e vijueshëm profesional, të organizuar pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë (IEKA). Partnerët dhe të gjithë punonjësit e INTRUST, kryejnë trajnimet e përcaktuara sipas nivelit të pozicionit të tyre, për kualifikimin e vijueshëm profesional, në platforma, webinar të ndryshme, në bazë të një plani vjetor. Ne investojmë kohë të mjaftueshme për të përmirësuar dhe rritur vazhdimisht aftësinë profesionale të stafit tonë, duke hartuar programe trajnimi në përputhje me pozicionin dhe nevojat për të mësuar, zhvilluar dhe kryer vlerësimin e zhvillimit profesional dhe identifikuar aspektet e nevojshme për përmirësim. Në kulturën e punës tonë, konsultimi në ekip është pika jonë e fortë dhe nxisim punonjësit që të konsultohen për çështje të vështira ose që kërkojnë diskutim. Këto konsultime përmirësojnë procesin e rritjes së kapaciteteve tona të brendshme dhe zhvillimit të stafit, duke krijuar vlerë në njohuritë e përbashkëta, kontrollin e cilësisë dhe aftësive profesionale.

Partnerët dhe stafi janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrave të tyre të zhvillimit profesional.

8. Informacioni financiar

Të ardhurat e shoqërisë të realizuara gjatë vitit 2024 analizohen si më poshtë:

Të ardhurat	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 (në mijë lekë)
Të ardhura nga shërbime auditimi	39,288
Të ardhura nga shërbime të tjera	1,526

9. Bazat e shpërblimit të ortakëve të angazhimit

Shpërblimi i partnerëve në INTRUST Shpk bazohet në faktorë të tillë si:

- ❖ Cilësia e punës së kryer;
- ❖ Kontributi në menaxhimin dhe zhvillimin e firmës;
- ❖ Performanca individuale dhe kolektive.

© 2024

Ky raport dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë e drejtë autori. Të gjithë të drejtat janë të rezervuara për INTRUST Shpk. Kopjimi dhe përhapja e të dhënave apo përdorimi tregtar i këtij raporti nuk është i lejuar përveç kur jepet miratim me shkrim. Është i ndaluar vendosja e këtij raporti në faqe interneti edhe kur kjo bëhet pa pagesë, nëse nuk është marrë aprovimi paraprak nga INTRUST Shpk. Përdorime të tjera që nuk parashikohen në këtë seksion janë të lejuara vetëm nëse burimi i informacionit citohet me saktësi “Raporti i transparencës – 2024 Intrust Shpk”.



 www.intrust.al

Rruga e Kosovarëve, Kompleksi Lake View, shkalla B, Kati 2,
Tirana, Albania